



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**

**Nr.76, datë 08.12.2004**

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SISTEMIT  
SHQIPTAR TË PAGESAVE NDËRBANKARE - AIPS**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 shkronja "dh" dhe të nenit 21, të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës, si dhe të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare - AIPS" miratuar me vendimin nr.103, datë 10.12.2003, të bëhet ndryshimi si më poshtë:  
  
Paragrafi "3.1.2. Operatorët e sistemit", të ndryshojë në "Operatorë të sistemit, të cilët shlyejnë veprimet nëpërmjet AIPS, do të jenë Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjera, që përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë".
2. Ngarkohen Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**

**Nr. 78, datë 08.12.2004**

**PËR MIRATIMIN E "KRITEREVE PËR CAKTIMIN E ÇMIMEVE TË BLERJES  
DHE TË SHITJES PËR KARTËMONEDHAT DHE MONEDHAT METALIKE,  
VLERA TË TJERA NUMIZMATIKE, AMBALAZHE DHE KATALOGË, SI DHE  
TË METODIKËS PËR LLOGARITJEN E ÇMIMEVE TË TYRE"**

Në mbështetje të nenit 43, gërma c, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI :**

1. Të miratojë "Kriteret për caktimin e çmimeve të blerjes dhe të shitjes për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, ambalazhe dhe katalogë", sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë "Metodikën për llogaritjen e çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike me dhe pa kurs ligjor, si dhe për katalogun e tyre", sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 22/3/97, datë 10.10.1997 dhe nr. 80, datë 03.10.2001, shfuqizohen.
4. Ngarkohen Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe i Pagesave me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**

**BANKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli Mbikëqyrës**

**SHTOJCË Nr. 1**

Miratuar me vendimin nr. 78 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,  
datë 08.12.2004

**“KRITERET PËR ÇAKTIMIN E ÇMIMEVE TË BLERJES DHE TË SHITJES  
PËR KARTËMONEDHAT DHE MONEDHAT METALIKE, VLERA TË TJERA  
NUMIZMATIKE, AMBALAZHE DHE KATALOGË”**

**1. Qëllimi :**

Me anë të këtij akti synohet formalizimi i politikave për hartimin dhe për miratimin e kriterëve të përgjithshme, që ndiqen nga Banka e Shqipërisë, në procedurat e përcaktimit të çmimeve të blerjes dhe të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike për qëllime numizmatike, me synim nxitjen e aktivitetit numizmatik me vlerat e Bankës së Shqipërisë.

**2. Përkufizime:**

Për efekt të përdorimit në këtë akt:

2.1 Shprehja **“kartëmonedha e monedha metalike, me vlera numizmatike”**, kupton:

- a) Kartëmonedha e monedha metalike që kanë kurs ligjor Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) Kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, të emetuara në vite dhe që nuk kanë kurs ligjor;
- c) Kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, të shtypura vetëm për qëllime numizmatike;
- d) Çeqe, bono lek dhe vlera të tjera me karakter numizmatik, sipas përcaktimit nga Banka e Shqipërisë;

2.2 Shprehja “**gjendje fizike të kartëmonedhave e monedhave metalike**”, kupton shkallën e cilësisë të një kartëmonedhe apo monedhe metalike, e cila klasifikohet në :

- a) *UNC (uncirculated) e paqarkulluar*, është një kartëmonedhë e ruajtur në mënyrë perfekte, në të cilën letra është e pastër, nuk ka asnjë njollë, anët janë të drejta dhe të lëmuara, pa asnjë deformim të letrës dhe një monedhë, në të cilën nuk ka asnjë shenjë përdorimi apo prekjeje me dorë, me cilësi të njëjtë si ajo e ardhur direkt nga prodhimi;
- b) *XF (extremely fine) e shkëlqyer*, është një kartëmonedhë shumë e mirë, e cila mund të ketë prekje të lehta me dorë dhe dy-tre rrudha të lehta në anët e kartëmonedhës (por që mund të jetë deformuar për shkak të paketimit apo të ambientit ku mbahet) dhe një monedhë metalike, e cila ka rreth 95 për qind të detajeve origjinale të dukshme ose një monedhë me asnjë dëmtim në detajet e brendshme të saj.
- c) *VF (very fine) shumë e mirë*, është një kartëmonedhë e mirë por që ka përdorime të dukshme, ka përthyerje vertikale dhe horizontale, letra mund të ketë papastërti dhe njolla të lehta; dhe një monedhë metalike, e cila ruan rreth 75 për qind të detajeve origjinale të saj, gërmat dhe shifrat mund të jenë pak të konsumuara, monedha mund të jetë e një cilësie mesatare.
- d) *F (fine) e mirë*, është një kartëmonedhë e cila ka qarkulluar konsiderueshëm, ka njolla dhe rrudha të dukshme; dhe një monedhë metalike, e cila ka rreth 50 për qind të detajeve origjinale të dukshme, ka gërmat dhe anët të konsumuara, në përgjithësi monedha duket e zbehtë.
- e) *VG (very good) në kushte të mira*, është një kartëmonedhë e përdorur, por akoma është e padëmtuar; dhe një monedhë metalike e cila ka të dukshme rreth 25 për qind të detajeve origjinale të saj.

2.3 Shprehja “**kritere të caktimit të çmimit**”, ka të bëjë me përcaktimet e faktorëve që duhen mbajtur në konsideratë gjatë projektimit të një çmimi.

2.4 Shprehja “**strukturë çmimi**”, nënkupton elementet përbërëse të formimit të çmimit të blerjes apo të shitjes.

2.5 Shprehja “**koleksionim**”, nënkupton grumbullimin e çdo kartëmonedhe, monedhe metalike, bono Lek, çek etj., me qëllim ruajtjen në albume apo edhe ekspozimin në panairë dhe ekspozita të ndryshme.

2.6 Shprehja “**katalogë ndërkombëtarë**”, nënkupton katalogët standardë ndërkombëtarë të kartëmonedhave dhe monedhave: “World Paper Money” dhe “World Coins”, të botuara nga Krause Publications INC, të cilët përdoren nga të gjitha organizmat numizmatë në botë.

2.7 Shprehja "*Metodikë e llogaritjes së çmimeve*", nënkupton mënyrën (anën teknike) e llogaritjes së çmimeve.

### **3. Kriteret e caktimit të çmimeve të blerjes së kartëmonedhave dhe të monedhave metalike për qëllime numizmatike.**

3.1 Banka e Shqipërisë, ndjek politikën e pasurimit të fondit numizmatik të saj edhe me mbledhjen e vlerave të rralla numizmatike të vendit. Ajo mund të blejë kartëmonedha e monedha metalike dhe vlera të tjera numizmatike shqiptare, vetëm për efekt koleksionimi, pa të drejtën e tregtimit të mëtejshëm të tyre.

3.2 Për përcaktimin e çmimeve të blerjes së kartëmonedhave e monedhave për qëllime koleksionimi, mbahen parasysh këto kritere:

3.2.1 Katalogët më të fundit ndërkombëtarë të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shërbejnë si bazë për orientimin në përcaktimin e çmimeve të blerjes. Çmimi i blerjes është sa vlerësimi në katalogë pakësuar me një përqindje të caktuar ndaj tij, sipas pikës 3.2.4. të këtij akti.

3.2.2 Rrallësia e kartëmonedhës apo e monedhës metalike.

Për kartëmonedha e monedha metalike të rralla e me tirazh të vogël, siç janë: kartëmonedhat lokale të para vitit 1926, kartëmonedhat 100 Franga Ari të vitit 1926, 1 Frang e vitit 1945, si dhe disa monedha me material Ar, të viteve 1926-1938), në përcaktimin e çmimit të aplikohet 100 për qind e vlerësimit të tyre në katalogët, sipas pikës 3.2.1 të këtij akti.

3.2.3 Tregu, kërkesa dhe oferta.

Në rast se një vlere numizmatike është tepër e rrallë dhe nuk gjendet në katalogët ndërkombëtarë, çmimi i saj do të jetë çmimi i tregut.

3.2.4. Gjendja fizike e kartëmonedhave dhe monedhave metalike.

Duke iu referuar klasifikimeve të gjendjes fizike të një kartëmonedhe apo të një monedhe metalike, të përcaktuara në pikën 2 të këtij akti, çmimi diferencohet ndaj vlerësimit të bërë në katalogë si vijon:

- a) për shkallën UNC, jo më pak se 85 për qind e çmimit të publikuar;
- b) për shkallën XF, jo më pak se 65 për qind e çmimit të publikuar;
- c) për shkallën VF, jo më pak se 50 për qind e çmimit të publikuar;
- d) për shkallën F, jo më pak se 40 për qind e çmimit të publikuar;
- e) për shkallën VG, jo më pak se 30 për qind e çmimit të publikuar.

Ky kriter nuk zbatohet për kartëmonedhat dhe monedhat metalike të përmendura në pikat 3.2.2 dhe 3.2.3 të këtij akti.

**4. Kriteret e caktimit të çmimeve të shitjes për kartëmonedha, monedha metalike, që kanë ose nuk kanë kurs ligjor, për kartëmonedha e monedha të shtypura për qëllime numizmatike, për ambalazhet si dhe për katalogët e tyre.**

4.1 Caktimi i çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike, që nuk kanë kurs ligjor, bëhet mbi bazën e katalogëve më të fundit ndërkombëtarë të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike, të cilët janë gjithmonë orientues në përcaktimin e çmimeve. Çmimi i shitjes është sa vlerësimi në katalogë pakësuar me një përqindje të caktuar ndaj tij, sipas pikës 3.2.4 të këtij akti.

4.2 Çmimet për fondin për shitje në Arkën Numizmatikë caktohen në përputhje me gjendjen (cilësisë) fizike të kartëmonedhave e monedhave metalike, sipas shkallëzimeve të pikës 3.2.4, të këtij akti.

4.3 Caktimi i çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike, të cilat kanë kurs ligjor, bëhet mbi bazën e vlerës nominale. Çmimi i shitjes është vlera nominale shtuar me fitimin në përqindje ndaj vlerës nominale.

4.4 Caktimi i çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike të shtypura për qëllime numizmatike, pas vitit 2000 (të cilat nuk janë publikuar në katalogët ndërkombëtarë sipas pikës 4.1 të këtij akti), si dhe për ambalazhe me realizim artistik e katalogë, bëhet mbi bazën e kostos së realizimit, me të cilën ato janë regjistruar në cashbook. Çmimi i shitjes është kosto e realizimit shtuar me fitimin në përqindje mbi këtë kosto.

4.4.1 Fitimi.

Fitimi nga aktiviteti i shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike, të cilat kanë kurs ligjor është:

- a) në masën 50 për qind për kartëmonedha me vlerë nominale nga 200 deri në 1000 lekë, emisione të viteve 1991-1996.
- b) në masën 10 për qind për kartëmonedha me vlerë nominale nga 500 deri në 5000 lekë, emisione të pas vitit 1996 (përfshi edhe emisionin e ri të vitit 1996), duke mos aplikuar diferencime për çmimet e shitjes me shumicë;
- c) në masën 100 për qind për kartëmonedha e monedha metalike me vlerë nominale 100 lekë;
- d) në masën 200 për qind, për monedhat metalike me vlerë nominale nga 50 deri në 10 lekë;
- e) në masën 500 për qind për monedhat metalike 5 dhe 1 lek.

Ky kriter aplikohet deri në momentin që kartëmonedhat e monedhat metalike kanë kurs ligjor, pasi me heqjen e kursit ligjor, përcaktimi i çmimit të shitjes do të të jetë vlerësimi në katalogë.

Fitimi nga aktiviteti i shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike, të shtypura për qëllime numizmatike, pas vitit 2000 (të cilat nuk janë publikuar në katalogët ndërkombëtarë sipas pikës 4.1 të këtij akti, është:

- a) në masën 50 për qind për monedha me material ar dhe argjend;
- b) 200 për qind për monedha me material të thjeshtë;
- c) 100 për qind për katalogë, mbi koston e realizimit.

4.5 Për shitje në sasi të mëdha të kartëmonedhave e monedhave metalike, gjendje në Bankën e Shqipërisë, do të ketë diferencim të çmimit sipas sasisë.

4.5.1 Për vlerat numizmatike, për katalogët dhe për ambalazhin e tyre, të cilat disponohen në sasi të mëdha (mbi ato të përcaktuara për shitje me pakicë) aplikohen çmime me shumicë.

4.5.2. Shitje me pakicë.

Do të konsiderohet shitje me pakicë, sasia për një transaksion:

- a) nga 1 deri në 9 copë (përfshi numrin 9) e kartëmonedhave, monedhave metalike dhe vlera të tjera numizmatike; dhe
- b) prej 1 copë e katalogut të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare. Për shitjet me pakicë aplikohen çmimet e shitjes me pakicë, të miratuara sipas pikës 6 të këtij akti.

4.5.3. Shitje me shumicë.

Do të konsiderohet shitje me shumicë sasia për një transaksion e:

- a) mbi 10 copë (përfshi numrin 10) të kartëmonedhave, të monedhave metalike dhe të vlerave të tjera numizmatike.
- b) mbi 2 copë e katalogut të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare

Për shitjet me shumicë të kartëmonedhave, monedhave metalike dhe vlerave të tjera numizmatike, aplikohet zbritje nga çmimi me pakicë si më poshtë:

- për sasi të nga 10-39 copë aplikohet zbritje në masën 5 për qind të çmimit me pakicë;

- për sasi të nga 40 - 69 copë aplikohet zbritje në masën 10 për qind të çmimit me pakicë;
- për sasi të nga 70 deri 99 copë aplikohet zbritje në masën 15 për qind të çmimit me pakicë;
- për sasinë mbi 100 copë aplikohet zbritje në masën 20 për qind të çmimit me pakicë;

Për shitjet me shumicë të “Katalogut të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare“ aplikohet zbritje nga çmimi me pakicë, si më poshtë:

- për sasi të nga 2 - 9 copë aplikohet zbritje në masën 10 për qind të çmimit me pakicë;
- për sasi të nga 10 - 24 copë aplikohet zbritje në masën 15 për qind të çmimit me pakicë;
- për sasi të mbi 25 copë aplikohet zbritje në masën 20 për qind të çmimit me pakicë.

*4.5.4. Për shitjet në sasi mbi 50.000 copë të kartëmonedhave apo monedhave metalike, me propozim të Departamentit të Emisionit dhe me miratim të Guvernatorit, aplikohet zbritja e çmimit deri në masën 40 për qind të çmimit të shitjes me pakicë.*

4.6 Çmimet, do të caktohen të veçanta për çdo prerje kartëmonedhe apo monedhë metalike.

4.7 Në rastin e aplikimit të çmimeve për seri të kartëmonedhave e monedhave metalike, çmimi do të jetë shumatorë e çmimeve të veçanta të prerjeve përbërëse të serisë.

4.8 Projektimi i çmimeve të shitjes mban në konsideratë politikën e Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e tregut numizmatik, për njohjen e vlerave numizmatike të vendit si dhe për realizim të fitimit nga kjo veprimtari.

4.9 Çmimet për prerjet çeçe, bono Lekë dhe vlera të tjera numizmatike të caktohen duke iu referuar të njëjtave kriterë të caktimit të çmimeve ashtu sikurse veprohet edhe për caktimin e çmimeve të kartëmonedhave e monedhave metalike (me kosto dhe vlerë katalogu).



## **5. Çaktimi dhe miratimi i çmimeve.**

- 5.1 Çmimet e shitjes dhe të blerjes, përcaktohen në Lekë.
- 5.2 Çmimet e shitjes dhe të blerjes të kartëmonedhave, të monedhave metalike, të katalogut dhe të ambalazheve të tyre, propozohen nga Departamenti i Emisionit dhe miratohen nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.
- 5.3 Procedurat kontabile, të cilat do të aplikohen për shitje me klientë të huaj, përcaktohen nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave.
- 5.4 Për rastet e shitjeve me klientë të huaj, klientëve të huaj u njoftohen çmimet e shitjes në Lekë shoqëruar me kursin e këmbimit të Reuters të ditës paraardhëse, i cili do të jetë i vlefshëm për një afat kohor deri në 15 ditë kalendarike. Në rastin e kalimit të këtij afati, sipas kërkesës, klientit i ridërgohen çmimet shoqëruar me kursin e ditës paraardhëse.

## **6. Struktura e çmimeve të shitjes.**

- 6.1. Në përbërje të strukturës së çmimeve të shitjes për kartëmonedhat (përfshi specimene dhe jospecimene) dhe monedhat metalike, me vlera numizmatike, që kanë ose nuk kanë kurs ligjor, hyjnë:
  - a) Çmimi i miratuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, sipas pikës 5.2 të këtij akti.
  - b) Çmimi i ambalazhit, i cili përbëhet nga kostoja e shtypit shtuar me 10 për qind fitim.
  - c) Tarifa e transportit;
  - d) T.V.SH. në përqindje  $(a+b) \times d$ .
- 6.2. Në përbërje të strukturës së çmimit të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike të shtypura për qëllime numizmatike, pas vitit 2000 (të cilat nuk janë pasqyruar në katalogët sipas pikës nr. 3.2.1. të këtij akti), si dhe të "katalogut të kartëmonedhave e monedhave shqiptare", hyjnë:
  - a) Çmimi i miratuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, sipas pikes 5.2 të këtij akti.
  - b) Çmimi i ambalazhit, i cili përbëhet nga kostoja e shtypit shtuar me 10 për qind fitim.

c) Tarifa e transportit.

d) T.V.SH. në përqindje  $(a+b) \times d$ .

6.3 Struktura e çmimit (pikat 6.1 dhe 6.2 të këtij akti) nuk zbatohet plotësisht në rastet kur vlerat numizmatike dhe vlerat e tjera, shiten të paambalazuara dhe kur nuk zbatohet shpenzim transporti për këtë shërbim.

## SHTOJCË Nr. 2

Miratuar me vendimin nr. 78 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,  
datë 08.12.2004

### METODIKË PËR LLOGARITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE METALIKE ME DHE PA KURS LIGJORSI DHE PËR KATALOGUN E TYRE

- I. Për llogaritjen e çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike që nuk kanë kurs ligjor do të veprohet sipas kësaj metodike.

*Pasqyra nr. 1*

KARTËMONEDHA MONEDHA	Çmimi është në USD	Vlerësimi* në kalatog në USD	Diferenca në % (-) ndaj vl.katalogut	Çmimi i propozuar në USD	Çmimi i propozuar në Lekë	Sasia dhe fitimi i diferencuar për shitje me shumicë			
						Çmimi lek për	Çmimi lek për	Çmimi lek për	Çmimi lek për
						10-39 copë	40-69 copë	70-99 copë	mbi 100 copë
						- %	- %	- %	- %
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b> (3 + 4)	<b>6</b> (5 x kursi)	<b>7 = 6 - %</b>	<b>8 = 6 - %</b>	<b>9 = 6 - %</b>	<b>10 = 6 - %</b>

\* Kursi i cituar në kolonën 6 do të jetë ai i datës në të cilën çmimet do të paraqiten për miratim nga Departamenti i Emisionit .

- II. Për llogaritjen e çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike që kanë kurs ligjor do të veprohet sipas kësaj metodike.

*Pasqyra nr.2*

KARTËMONEDHA MONEDHA	Çmimi është në USD	Vlera nominale	Fitimi në % (+) ndaj vlerës nominale	Çmimi i propozuar në Lekë	Sasia dhe fitimi i diferencuar për shitje me shumicë			
					Çmimi lek për	Çmimi lek për	Çmimi lek për	Çmimi lek për
					10-39 copë	40-69 copë	70-99 copë	mbi 100 copë
					- %	- %	- %	- %
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b> (3+4)	<b>6 = 5 - %</b>	<b>7 = 5 - %</b>	<b>8 = 5 - %</b>	<b>9 = 5 - %</b>

- III. Për llogaritjen e çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike që janë evidentuar në *cashbook* me kosto shtypi, do të veprohet sipas kësaj metodike.

*Pasqyra nr.3*

KARTËMONEDHA MONEDHA KATALOGË	Çmimi është në USD	Kosto e realizimit	Fitimi në % (+) ndaj koston së realizimit	Çmimi i propozuar në Lekë	Sasia dhe fitimi i diferencuar për shitje me shumicë			
					Çmimi lek për	Çmimi lek për	Çmimi lek për	Çmimi lek për
					10-39 copë	40-69 copë	70-99 copë	mbi 100 copë
					- %	- %	- %	- %
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b> (3+4)	<b>6 = 5 - %</b>	<b>7 = 5 - %</b>	<b>8 = 5 - %</b>	<b>9 = 5 - %</b>

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004**

1. Vendim nr.01, datë 28.01.2004 Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2003”.
2. Vendim nr.02, datë 28.01.2004 Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004 Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr.75, datë 25.09.2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004 Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SWIFT” miratuar me vendimin nr.16, datë 01.03.2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01.2004 Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004**

1. Vendim nr.06, datë 11.02.2004 Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr.07, datë 11.02.2004 Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004**

1. Vendim nr.08, datë 25.02.2004 Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004 Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr.10, datë 25.02.2004 Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.
5. Vendim nr.12, datë 25.02.2004 “Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003”.

6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004 Për “Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo- Shqiptare”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004**

1. Vendim nr.16, datë 10.03.2004 Për “Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare”.
2. Vendim nr.17, datë 10.03.2004 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004**

1. Vendim nr.20, datë 24.03.2004 Për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës”.
2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës” miratuar me vendimin nr.57, date 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr.40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.
3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004 Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.
4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004 Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Prill 2004**

1. Vendim nr.26, datë 14.04.2004 Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve.
2. Vendim nr.27 datë 14.04.2004 “Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004**

1. Vendim nr.28, datë 28.04.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.
2. Vendim nr.29, datë 28.04.2004 Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi kredinë njëditore”.
3. Vendim nr.30, datë 28.04.2004 Për dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”.

4. Vendim nr.31, datë 28.04.2004 Për “Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004**

1. Vendim nr.35, datë 12.05.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004**

1. Vendim nr.36, datë 26.05.2004 Për miratimin e Raportit “Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.37, datë 26.05.2004 Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.
3. Vendim nr.38, datë 26.05.2004 Për miratimin e rregullores “Për adiministrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë”.
4. Vendim nr.39, datë 26.05.2004 Për miratimin e rregullores “Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 10, Qershor 2004**

1. Vendim nr.46, datë 09.06.2004 Për “Politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 11, Qershor 2004**

1. Vendim nr.47, datë 18.06.2004 Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2004”.
2. Vendim nr.48, datë 18.06.2004 “Për disa ndryshime në rregulloren për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 12, Qershor 2004**

1. Vendim nr.50, datë 23.06.2004 “Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

2. Vendim nr.51, datë 23.06.2004 Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 13, Korrik 2004**

1. Vendim nr.52, datë 14.07.2004 Për "Administrimin e rrezikut të kredisë".
2. Vendim nr.53, date 14.07.2004 Për "Shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, në vitin 2005".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 14, Korrik 2004**

1. Vendim nr.56, datë 28.07.2004 Për "Miratimin e raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2004".
2. Vendim nr.57, datë 28.07.2004 Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".
3. Vendim nr.58, datë 28.07.2004 Për "Miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri"".
4. Vendim nr.59, datë 28.07.2004 Për "Lirimin nga detyra të Drejtorit aktual dhe emërimin e Drejtorit të ri të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 15, Gusht 2004**

1. Vendim nr.60, datë 18.08.2004 Për "Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin korrik të vitit 2004".
2. Vendim nr.61, datë 18.08.2004 Për "Miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të bankës së kursimeve sh.a. nga Raiffeisen Zentralbank Österreich AG tek Raiffeisen International Bank-Holding AG.
3. Vendim nr.62, datë 18.08.2004 Për "Miratimin e rregullave të funksionimit të sistemit IDBS".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 16, Shtator 2004**

1. Vendim nr.66, datë 22.09.2004 Për "Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin gusht të vitit 2004".

**Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 17, Nëntor 2004**

1. Vendim nr.67, datë 04.11.2004 Për “Miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.68, datë 04.11.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”.

**Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 18, Dhjetor 2004**

1. Vendim nr.73, datë 24.11.2004 Për “Miratimin e Raportit të Politikës Monetare për muajin tetor të vitit 2004”.
2. Vendim nr.74, datë 24.11.2004 Për “Zgjedhjen dhe emërimin e Zëvendësguvernatorëve të Bankës së Shqipërisë”.
3. Vendim nr.75, datë 24.11.2004 Për “Miratimin e emërimit të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore e Juridik të Bankës së Shqipërisë”.